



Titulli i projektit

Krijimi i skemave të kreditimit për operatorët turistikë familjarë (Bashkia Klos dhe Mat)

Tipi i projektit

Zhvillim ekonomik nëpërmjet zgjerimit të të ardhurave nga aktivitetet e Shërbimeve

Vendndodhja e projektit

Bashkia Klos dhe Mat

Buxheti i paravlerësuar

100,000,000 lekë + pjesa për t'u vlerësuar

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve

Territori i bashkive Mat dhe Klos është i pasur me resurse turistike, por infrastruktura turistike pranë këtyre zonave është e pazhvilluar, ose joekzistente. Megjithatë, turizmi familjar mund të jetë një alternativë tërheqëse dhe konkurruese me ndikim të menjëhershëm në të ardhurat e ekonomive familjare. Për të arritur në këtë rezultat, është e nevojshme të investohet në përmirësimin e ambienteve të brendshme të shtëpive private, që të shërbejnë si njësi pritëse për turistët individualë në njësitë malore. Disponueshmëria e një fondi kreditimi të hapur ndaj kreditimit të këtij lloji shërbimi, do të përmirësonte cilësinë dhe do të rriste standardin e shërbimit në këtë drejtim.

Qëllimi/et specifik të projektit

Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm, duke shfrytëzuar resurset turistike lokale dhe rritur cilësinë e shërbimit.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Krijimi i një fondi dhe skeme financimi të investimeve, me qëllim turizmin familjar, me kredi me kushte lehtësuese (një fond prej 100,000,000 Lekë), i hapur për aplikim nga operatorët familjarë;
- Të paktën një e treta e operatorëve turistikë të identifikuar shërbehet, ose rimbursohet çdo vit nga fondi i kreditimit (një e treta e njësive familjare të identifikuar të shërbyera).
- Rritje e turizmit familjar dhe të ardhura të shtuara vendore (numri i turistëve familjarë dhe i të ardhurave në shkallë vendore nga turizmi më i lartë se në tre vitet e fundit, para krijimit të shoqatës).

PROJEKTI 13



program i zonave funksionale

pzf

Aktivitetet e projektit

- Krijimi i fondit dhe skemës së financimit në bashkëpunim me donatorët, ose institucionet kredituese.
- Aplikimi dhe marrja e kredive, apo rimbursimit për investimet në ekonomitë familjare, me qëllim final turizmin familjar.
- Investimet familjare në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit.
- Aktivitete promovionale dhe informuese mbi mundësitë e shërbimit nga shoqata e operatorëve të hotelerisë dhe restoranteve.

Maturimi i projektit

Nuk ka një koncept fillestar dhe fazë paraprake të këtij projekti.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së Lirë;
- Donatorët;
- Banka, institucione mikrofinance.

Partnerët:

- Bashkia Mat dhe Klos;
- Ministria e Bujqësisë, Ministria e Ekonomisë, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes së Lirë;
- Donatorë: BE, BB, USAID, GIZ;
- BERZH, ProCredit, Institutet e Mikrofinancës

Kostot e projektit

Krijimi i fondit dhe skemës së financimit, në bashkëpunim me donatorët, ose institucionet kredituese 100,000,000

Aplikimi dhe marrja e kredive, apo rimbursimit për investimet në ekonomitë familjare, me qëllim final turizmin familjar 0

Investimet familjare në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit

Pjesa e pjesëmarrjes nga operatorët familjarë për t'u vlerësuar

Aktivitete promovionale dhe informuese mbi mundësitë e shërbimit nga shoqata e operatorëve të hotelerisë dhe restoranteve.

Për t'u vlerësuar në funksion të mënyrës dhe mediumit të shpërndarjes

Total: 100,000,000

+ pjesa për t'u vlerësuar